



Prishtinë: 27.04.2017

Kodi i ZRRE-së: V_915_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1561_02_16**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **20.10.2017**.

në seancën e mbajtur më datë **27.04.2017**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **APROVOHET** ankesa e konsumatorit R. M., nga fshati Dragoc, Komuna e Prishtinës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **OBLIGOHET** KEDS të investojë në pjesën e rrjetit elektrik në fshatin Dragoc, ku konsumatori R. M. ka parashtruar kërkesë për kthimin e rrjetit elektrik nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Arsyetim

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 20.10.2016 është parashtruar ankesa nga konsumatori R. M. nga fshati Dragoc lidhur me kthimin e rrjetit elektrik në gjendjen e mëparshme si dhe dhënia e lidhjes së re nga ana e KEDS dhe KESCO. Në ankesën e konsumatorit drejtuar ZRRE-së është theksuar se prej nga pas lufta në atë pjesë të fshatit Dragoc ka pasur rrjet elektrik, por që është vjedhur dhe se tani nuk ka rrjet elektrik dhe se disa herë kanë parashtruar ankesë në KEK dhe tani KEDS por që nuk kanë marrë asnjë përgjigje me shkrim nga KEDS-i.

Me datë 19.09.2016 konsumatori R. M. në emër të banorëve të Fshatit Dragoc ka parashtruar kërkesë në KEDS për kthimin e gjendjes së rrjetit elektrik në fshatin Dragoc. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar KEDS-it ka theksuar se fshati i tyre nuk ka energji elektrike që nga pas lufta, dhe se disa herë kanë parashtruar kërkesë te operatori i sistemit të shpërndarjes, por që nuk kemi marrë përgjigje.

Provë: Kërkesa e konsumatorit e parashtruar në KEDS nr. 7956 e datës 19.09.2016

Lidhur me ankesën e konsumatorit, DMK ka dërguar disa shkresa zyrtare në KEDS (data 11.11.2016, 13.12.2016 dhe 20.02.2017) duke i kërkuar sqarime me shkrim lidhur me ankesën e konsumatorit ku theksohet se që nga pas lufta e tutje fshati Dragoc nuk ka energji elektrike, ekzistojnë shtylla elektrike në fshat por jo edhe përçues pasi që sipas konsumatorit janë vjedhur.

Me datë 21.02.2017, KEDS-i i është përgjigjur shkresës së ZRRE-së duke theksuar se sipas analizave të bëra nga KEDS rezulton se një rrjet tërësisht i ri duhet të ndërtohet pasi që rrjeti i vjetër nuk ekziston që disa vite (prej kohës para lufte 1999). Në përgjigjen e KEDS/KESCO gjithashtu është theksuar se nuk ka ndonjë konsumatorë të regjistruar në këtë anë, si dhe KEDS/KESCO nuk ka trashëguar asnjë konsumatorë në bazë të marrëveshjes mbi transferim të datës 07.05.2013. Në vazhdim të përgjigjes së KEDS-it është theksuar se KEDS-i është duke e shqyrtuar mundësinë e përfshirjes së kësaj zone në



Programin investiv siç parashihet në ligje, kode dhe buxhetin e kufizuar e të aprovuar nga Rregullatori. Në përgjigjen e KEDS-it është theksuar se nëse konsumatori dëshiron që të furnizohet sa më parë, atëherë do t'j konsiderohen si konsumatorë të ri dhe do të duhet t'i kryejnë të gjitha punët në rrjet bazuar në zgjidhjen teknike të dhënë nga KEDS. Gjithashtu në përgjigjen e KEDS-it është theksuar se nëse konsumatori dëshiron të vazhdojë punët sipas zgjidhjes teknike, KEDS është i gatshëm t'ju ndihmojë me përgatitjen e projektit dhe mbikëqyrjen e tij.

ZRRE ka analizuar me kujdes shkresat e lëndës dhe thekson se sa i përket konstatimit apo arsyesimit të KEDS-it që Departamenti i Investimeve në KEDS do të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes të kësaj zone në Programin Investiv siç parashihet në ligje, kode dhe buxhetin e aprovuar nga Rregullatori, kjo nuk qëndron sepse rrjeti elektrik në këtë pjesë të fshatit Dragoc që një kohë të gjatë është në gjendje të tillë ku mungojnë përçuesit dhe disa shtylla, dhe se për këtë kanë qenë të informuar dhe në diejri punëtorët e autorizuar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (atëkohë KEK dhe tani KEDS) dhe se që nga atëherë nuk kanë bërë përpjekje të paraqesin si projekt këtë fshat në planet e tyre zhvillimore/investive në ZRRE për aprovim. Sipas Rregullës për Çmime të OSSH-së, shtojca 3 – Baza e Aseteve të Rregulluara, paragrafi 7, pika 7.3 theksohet se: *“OSSH mund të aplikojë në çdo kohë te rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit me ndonjë projekt tjetër kapital në rastet kur mund të dëshkohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet bazës së aseteve të rregulluara në shqyrtimin periodik të ardhshëm”*.

Sipas Rregullës për çmime të OSSH, të gjitha asetet ekzistuese janë të përfshira në bazën e aseteve të rregulluara dhe për këto ZRRE gjatë procesit tarifar në tarifa lejon kosto në mirëmbajtjen e këtyre aseteve, pra konsumatorët paguajnë për zëvendësimin (pas amortizimit/zhvlerësimit) dhe mirëmbajtjen e këtyre aseteve, si dhe vetëm shitjet e aseteve gjatë periudhës rregullative do të zbriten nga baza e aseteve të rregulluara bazuar në vlerën e shitjes së tyre.

Lidhur me këtë ZRRE konstaton se pavarësisht se në çfarëdo gjendje janë trashëguar stabilimentet energjetike ekzistuese, KEDS-i e ka obligim ligjor që të bëjë mirëmbajtjen e këtyre stabilimenteve në atë mënyrë që t'i sigurojë konsumatorëve furnizim me energji elektrike në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi. Për më tepër neni 26 i Ligjit për energjinë përcakton se: *“Stabilimentet e reja dhe ato ekzistuese për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, termike ose të gazit natyror, do të jenë në pronat mbi të cilat ndërmarrja përkatëse e energjisë i gëzon të drejtat përkatëse të pronësisë, të shfrytëzimit ose të qasjes. Linjat dhe tubacionet për transmetim dhe shpërndarje të energjisë mund të kalojnë përmes mbi, në ose nën çdo pronë vetëm nëse ndërmarrja përkatëse e energjisë ka një servitut ose të drejtë të shfrytëzimit të pronës përkatëse, ose servituti apo e drejta e shfrytëzimit i jepet ose i merret nga ndërmarrja përkatëse energjetike në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji”*.

Në nenin 28 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Ligjit për Energjinë Elektrike, theksohet se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet që: *“Ofrimi i kyçjeve në rrjetin e shpërndarjes në pajtim me këtë ligj, për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit që kërkojnë një lidhje të tillë, në pajtim me kërkesat për kyçje të përcaktuara në Kodin e rrjetit të shpërndarjes”*.

Gjithashtu duhet theksuar se neni 51, paragrafi 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike, përcakton se: “Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruar në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes. Konsumatori ose prodhuesi duhet të informohet me shkrim për arsyet e çdo refuzimi të tillë”.



Gjithashtu edhe në nenin 10 të Rregullës për Kushtet e përgjithshme të Furnizimit me Energji, theksohet se, Operatori i Sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikues për kohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi, por që refuzimi të ipet me shkrim brenda afatit 30 ditor prej datës së dërgimit të aplikacionit. Në rastin në fjalë KEDS-si ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të të përcaktuara Ligjin për Energjin Elektrike të cekur më lartë, si dhe me dispozitat e Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, pasi që asnjëherë nuk i ka kthyer konsumatorit me shkrim arsyet e refuzimit të kyçjes së konsumatorit, si dhe asnjëherë nuk i ka kthyer përgjigje me shkrim lidhur me mundësinë e kthimit të rrjetit elektrik dhe kyçjes së tyre në rrjetin elektrik.

ZRRE për të analizuar sa më saktë lëndën e konsumatorit dhe gjendjen e rrjetit elektrik të asaj pjese, me datë 11.04.2017 kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë inqizimin dhe fotografimin e rrjetit ekzistues. Nga vizita në teren është konstatuar se shtyllat elektrike ekzistojnë, përveç disa shtyllave të cilat ose janë të rrëzuara ose nuk ekzistojnë fare. Nga vizita në teren është konstatuar se në këto shtylla (pjesë të rrjetit elektrik) nuk ka përçues i cili kalon nëpër shtylla. Sipas konstatimeve të punëtorëve të KEDS-it dhe banorëve të asaj pjese përçuesi është vjedhur dhe tani kanë mbetur vetëm shtyllat elektrike. Sipas ankesës së konsumatorit dhe banorëve të asaj pjese, ai rrjet elektrik ka ekzistuar më herët, por që për arsye të ndryshme dikush ka vjedhur përçuesin elektrik i cili kalon nëpër ato shtylla elektrike.

Provë: Fotografitë dhe inqizimi i gjendjes së rrjetit elektrike nga ZRRE

Nga krejt ajo që u theksua më lartë edhe përkundër faktit se iniciues i ankesës ka qenë konsumatori i lartshënuar, nga vizita në teren kemi vërejtur se ka edhe konsumator të tjerë që kanë shprehur interesim që të i rikthehet energjizimi i asaj pjese ashtu që të mund të parashtrajnë kërkesat e tyre për lidhje të re gjë për të cilat ZRRE ka marr edhe disa fotografi si dëshmi për nevojat e tyre për lidhje të re.

Pas analizimit të të gjitha dëshmimeve të prezantuara nga palët në kontest dhe Rekomandimin e paraqitur nga DMK, Bordi i ZRRE në mbledhjen e mabajtur me datë 27.04.2017, vendosi sipas dispozitivit të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit R. M.,
- KEDS dhe KESCO-s, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.